



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
Zyra për Komunikim Publik/ Ured za Javno Komuniciranje/ Public Communication Office

RAPORT GJITHËPËRFSHIRËS
INSTITUCIONEVE PUBLIKE PËR REALIZMIN E SË DREJTËS PËR QASJE NE DOKUMENTE PUBLIKE

RAPORTI VJETOR 2018

Prishtinë, mars 2019

Përmbajtja

Faqe

1. Përmbledhje	3
2. E drejta e qasjes në dokumente publike	3
2.1 Parimet themelore.....	3
2.2 Rregullimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në Kosovë	3
2.2.1 Aktet juridike	3
3. Kërkesat për qasje në dokumente publike	
3.1 Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike në institucionet e Republikës së Kosovës	4
3.1.1 Tri institucionet e nivelit qendror	4
3.2 Presidenca, Kuvendi i Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese	5
3.2.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Presidencë, Kuvend të Kosovës dhe Gjykatë Kushtetuese ..	5
3.2.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Presidencë, Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese ..	5
3.3 Të dhënat e përgjithshme	8
3.3.1 Numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike të institucioneve të Republikës së Kosovës	8
3.3.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në institucionet e Republikës së Kosovës	11
3.3.3 Institucionet që nuk kanë dërguar raporte	12
3.4 Qeveria e Republikës së Kosovës	13
3.4.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në agjencitë vartëse ...	13
3.4.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ministrinë dhe agjencitë e tyre vartëse...	17
3.5 Universitetet publike	20
3.5.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Universitetet publike	20
3.5.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Universitetet publike	21
3.6 Institucionet e Pavarura	23
3.6.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Institucionet e Pavarura	23
3.6.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Institucionet e Pavarura	25
3.7 Ndërmarrjet Publike	28
3.7.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Ndërmarrjet Publike	28
3.7.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Ndërmarrjet Publike	29
3.8 Komunitet e Republikës së Kosovës	30
3.8.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Komunitet e Republikës së Kosovës	30
3.8.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Komunitet e Republikës së Kosovës	32
4. Shtojcat	
4.1 Formulari i kërkesës për qasje në dokumente publike	35
4.2 Lista e kontakteve	36

HARTUES I RAPORTIT:

ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN NË ZYRËN E KRYEMINISTRIT

Arben Musliu, Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun

1. PËRMBLEDHJE

Në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, Zyra për Komunikim me Publikun e Zyrës së Kryeministrit është e obliguar të mbledhë raportet nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe të përgatisë Raport Gjithëpërfshirës vjetor, për realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike. Deri më tani janë hartuar shtatë raporte, ndërsa ky është raporti i tetë me radhë.

Duke marrë parasysh raportet që janë dërguar nga të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe lokal, të Republikës së Kosovës, mund të konstatojmë se numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike ka shënuar rënie, po ashtu është vërejtur një rënie e përqindjes së kthimit të përgjigjeve pozitive dhe në afat sipas ligjit. Në këtë Raport Gjithëpërfshirës janë të prezantuara në formë tabelare, dhe të analizuara të gjitha të dhënat e dërguara për institucionet e nivelit qendror dhe lokal. Poashtu, janë dhënë edhe profilet e kërkesve dhe palëve të interesuara për qasje në dokumente publike, natyra e kërkesave dhe mënyra se si janë proceduar ato. Zyra për Komunikim Publik e Zyrës së Kryeministrit duke parë nevojën për efikasitet më të madh të zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe sfidat me të cilat janë përballur zyrtarët dhe institucionet përkatëse ka hartuar Projektligjin e ri për Qasje në Dokumente Publike, në të cilin janë adresuar çështjet kryesore dhe rekomandimet e palëve të përfshira në këtë proces, i cili është proceduar për aprovim në Kuvendin e Kosovës.

2. E DREJTA E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE

2.1 Parimet themelore

E drejta për qasje në dokumente publike është e paraparë edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës në nenin 41, dhe hyn në kuadër të të drejtave dhe lirive themelore.

Në parim, dokumentet e institucioneve publike janë të hapura për qasje të publikut.

E drejta e qasjes në dokumente publike është e ndërlidhur edhe me: lirinë e shprehjes, lirinë e mediave, lirinë e tubimit apo lirinë e asociimit.

2.2 Rregullimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në Kosovë

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës në nenin 41, është e paraparë e drejta e qasjes në dokumente publike dhe në frymën e këtij neni, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, më 7 tetor 2010.

Secili individ e gëzon të drejtën për qasje në dokumente publike të institucioneve të Republikës së Kosovës.

2.2.1 Aktet juridike

Në Republikën e Kosovës qasja në dokumente publike rregullohet me këto akte juridike:

- **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

Neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton:

"1. Secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike."

"2. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara."

- **Ligji Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike**

Ligji për Qasje në Dokumente Publike garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike.

Në funksion të zbatimit me sukses të Ligjit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar:

1. Rregulloren nr. 04/2012 për evidencën zyrtare të kërkesave për qasje në dokumente publike;
2. Udhëzimin Administrativ nr.03/2011 për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun ;
3. Rregulloren nr.02/2012/MF për tarifat në qasje në dokumente publike;
4. Udhëzimin Administrativ (MAP) nr.01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike;
5. Udhëzimin Administrativ nr.02/2011, për portalin qeveritar të Republikës së Kosovës;
6. Udhëzimin Administrativ nr.2008/09 për transparencën në komuna

- **Ligjet tjera të ndërlidhura**

1. Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
2. Ligji nr.03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë;
3. Ligji nr.03/L-195 për Avokatin e Popullit;
4. Ligji nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative;
5. Ligji nr. 03/L-202 për konfliktet administrative;
6. Ligji nr. 04/L-184 për administrimin e punës në Zyrë

3. KËRKESAT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

3.1 Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike në institucionet e Republikës së Kosovës

Pasqyra e përgjithshme e të dhënave për kërkesa për qasje në dokumente publike nga Institucionet e të gjitha niveleve që kanë obligim zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Nga krahasimi i raporteve të viteve të kaluara rezulton se në nivel vendi ka rënie të numrit të kërkesave për qasje në dokumente publike, poashtu edhe rënie të përqindjes së lejitimit të qasjes, marrë parasysh statistikat nga viti në vit.

3.1.1 Tri institucionet e nivelit qendror janë paraqitur në fillim:

- Presidenca e Republikës së Kosovës
- Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Pastaj janë të prezantuara të dhënat e përgjithshme për Qeverinë, përfshirë Ministrinë dhe agjencitë vartëse, me gjithsejtë 83 institucione.

Poashtu, janë të prezantuara të dhënat e institucioneve të pushtetit lokal, në 38 komuna të Kosovës.

Më pas, janë përfshirë raportet për pesë universitet publike, 16 ndërmarrje publike dhe 30 institucione të pavarura, që janë të themeluara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Prej të gjitha institucioneve që raportojnë në Zyrën për Komunikim Publik në Zyrën e Kryeministrit sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, raportet e tyre këtë vit nuk i kanë dërguar 4 institucione të themeluara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si dhe 5 komuna të Republikës së Kosovës.

3.2 Presidenca, Kuvendi i Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese

3.2.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Presidencë, Kuvend të Kosovës dhe Gjykatë Kushtetuese

Në vitin 2018, në këto tri institucione qendrore janë pranuar gjithsejtë 25 kërkesa.

Tabela në vijim pasqyron numrin e kërkesave që parashtruara në institucionet qendrore të Republikës së Kosovës

Tabela nr. 1:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara në Presidencë, Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese

Emri i institucionit	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar/ Pa përgjigje	Qasja e kufizuar	Totali
Presidenca e Republikës së Kosovës	10	0	0	10
Kuvendi i Republikës së Kosovës	5	0	0	5
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	10	0	0	10
	25	0	0	25

3.2.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Presidencë, Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese

Tabela më poshtë pasqyron totalin e kërkesave të parashtruara në këto institucione.

Tabela nr.2:

Totali i kërkesave të shqyrtuara në Presidencë, Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese

Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar/ Pa përgjigje	Qasja e kufizuar	Totali
25	0	0	25

- Realizimi i qasjes në dokumente publike

Në vitin 2018, në Presidencë, Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese, iu është lejuar qasje në 100 për qind të gjitha kërkesave për qasje në dokumente publike.

Në figurën 1, janë paraqitur të dhënat që prezantojnë realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike në tri institucionet qendrore të Republikës së Kosovës.




Figura 1.
Realizimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në Presidencë, Kuvend dhe Gjykatë Kushtetuese

Kthimi i përgjigjeve sipas kërkesave

Tri institucionet qendrore, gjatë vitit 2018 kanë dërguar të gjitha përgjigjet në afatin e paraparë ligjor. Nuk ka pasur asnjë kërkesë që është refuzuar apo ka marrë përgjigje të pjesshme.

- **Mënyra e kërkesave të pranuar dhe e përgjigjeve të dërguara**

Në këto tri institucione, Zyra e Presidentit, Kuvendi i Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese, kërkesat kanë qenë të pranuar 100 për qind në formë elektronike.




Figura 2.
Forma e kërkesave të pranuar

Përgjigjet e dërguara nga këto tri institucione janë 88 për qind në mënyrë elektronike dhe 12 për qind në kopje fizike.




Figura 3.
Mënyra e dërgimit të përgjigjeve

- Profili i kërkesve të dokumenteve

Gjatë vitit 2018, kërkesit më të shpeshtë të dokumenteve kanë qenë gazetarët, me 44 për qind, pasuar nga shoqëria civile 24 për qind, individët me 16 për qind, operatorët ekonomik 12 për qind, dhe studentët me 4 për qind.




Figura 4.
Profili i kërkesve të dokumenteve

- Dokumentet e kërkuara në Presidencë, në Kuvendin e Kosovës dhe në Gjykatën Kushtetuese

Gjatë vitit 2018, në Presidencë, në Kuvendin e Kosovës dhe në Gjykatën Kushtetuese, kërkesat e dërguara kanë qenë 28 për qind për vendime, 28 për qind në buxhet dhe shpenzime, 12 për qind dosje tenderi, me nga 8 për qind janë statistika, kontrata dhe të dhëna arkivore, dhe 4 për qind janë procesverbale dhe letërkëmbime.




Figura 5.
Dokumentet e kërkuara tek institucionet qendrore

3.3 TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

3.3.1 Numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike të institucioneve të Republikës së Kosovës

Tabela nr. 3:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2018 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar/ Pa përgjigje	Qasja e pjesshme	Totali
Institucionet qendrore; Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	25	0	0	25
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	797	82	14	893
Institucionet e Pavarura	221	16	4	241
Universitetet	94	0	5	99
Ndërmarrjet Publike	135	4	1	140
Komunat	898	36	18	952
Totali	2170	138	42	2350

Me qëllim të ofrimit të mundësisë së krahasimit, në vijim po paraqesim të gjitha tabelat me të dhënat nga raportet e realizimit të së drejtës për qasje në dokumente publike nga vitet paraprake.

Tabela nr. 4:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2017 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar/ Pa përgjigje	Qasja e pjesshme	Totali
Institucionet qendrore; Presidenca, Kuvendi, Gjykata Kushtetuese	19	0	0	19
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	1171	45	18	1234
Institucionet e Pavarura	175	7	9	191
Universitetet	85	0	6	91
Ndërmarrjet Publike	53	3	0	56
Komunat	894	35	4	933
Totali	2397	90	37	2524

Tabela nr. 5:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2016 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucionet	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar/ Pa përgjigje	Qasja e pjesshme	Totali
Institucionet qendrore; Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	20	0	1	21
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	599	31	41	671
Institucionet e Pavarura	173	5	3	181
Universitetet	87	2	0	89
Ndërmarrjet Publike	122	2	0	124
Komunat	1049	22	12	1083
	2050	62	57	2169

Tabela nr. 6:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2015 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar/ Pa përgjigje	Qasja e pjesshme	Totali
Institucionet qendrore; Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	22	2	2	26
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	785	69	33	887
Institucionet e Pavarura	205	13	1	219
Universitetet	75	0	0	75
Ndërmarrjet Publike	84	1	2	87
Komunat	789	31	18	838
Totali	1960	116	56	2132

Tabela nr. 7:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2014 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
Institucionet qendrore; Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	27	2	4	0	0	33
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	736	9	25	25	56	851
Institucionet e Pavarura	156	6	4	2	2	170
Universitetet	15	1	0	0	0	16
Ndërmarrjet Publike	59	0	0	0	0	59
Komunat	846	18	9	24	26	923
Totali	1866	36	38	50	83	2073

Tabela nr. 8:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2013 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
Institucionet qendrore; Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	26	2	1	0	0	29
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	1095	11	26	34	7	1173
Institucionet e Pavarura	156	6	4	2	2	170
Ndërmarrjet Publike	59	0	0	0	0	59
Komunat	497	18	19	28	6	568
Totali	1833	37	50	64	15	1999

Tabela nr. 9:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2012 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucionet / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
Institucionet qendrore; Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	45	1	/	/	/	47
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	540	52	8	/	15	615
Institucionet e Pavarura	79	4	1	/	2	86
Ndërmarrjet Publike	8	/	/	/	/	8
Komunat	530	36	8	/	14	588
	1202	93	17	/	31	1343

3.3.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në institucionet e Republikës së Kosovës

Nga të dhënat e paraqitura në formë tabelare që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, shihet se numri i kërkesave për qasje ka shënuar rritje, me përjashtim të vitit 2018, ku krahasuar me vitin paraprak ka rënie të numrit të kërkesave dhe kthimit të përgjigjeve pozitive. Që nga fillimi i zbatimit të Ligjit në vitin 2012, kur numri i kërkesave ka qenë gjithsejtë 1343, qasja e lejuar ka qenë për 1202 kërkesa apo 90 për qind, qasja e refuzuar 93 kërkesa apo 7 për qind, dhe të tjera 31 kërkesa apo 2 për qind. Ndërsa në vitin 2017, nga gjithsejtë 2524 kërkesa qasja e lejuar është 2397 apo 95 për qind, qasja e refuzuar dhe pa përgjigje është 90 apo 4 për qind dhe qasja e pjeshme 37 apo 1 për qind, ndërsa në vitin 2018, kemi një rënie të numrit të kërkesave për qasje në dokumente publike krahasuar me vitin paraprak, gjithsejtë janë parashtruar 2350

kërkesa, prej tyre 2170 kërkesave i është dhënë qasje apo 92 për qind, 138 kërkesa janë refuzuar dhe pa përgjigje apo 6 për qind dhe 42 kërkesave i është dhënë qasje e pjeshme apo 2 për qind.




Figura 6.

Realizimi i përgjithshëm i së drejtës për qasje në dokumente publike në institucionet e Republikës së Kosovës – krahasimi i viteve që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike

3.3.3 INSTITUCIONET QË NUK KANË DËRGUAR RAPORTE

- Institucionet që nuk kanë dërguar raportin vjetor për qasje në dokumente publike që parashihet në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike janë të paraqitura në tabelën më poshtë:

- Institucioni i Avokatit të Popullit
- Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- Këshilli Prokurorial i Kosovës

- Komunat të cilat nuk kanë dërguar raporte

Janë edhe disa komuna të cilat nuk e kanë përgatitur dhe dërguar raportin për numrin e kërkesave për qasje në dokumente publike.

- Komuna e Dragashit
- Komuna e Mitrovicës së Veriut
- Komuna e Graçanicës
- Komuna e Klllokotit
- Komuna e Zveçanit
- Komuna e Zubin Potokut

3.4 QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

3.4.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në agjencitë vartëse

Numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike gjatë vitit 2018, në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ku përfshihen Zyra e Kryeministrit, ministrinë dhe agjencitë e tyre vartëse, ka shënuar rënie. Gjatë vitit 2018, numrin më të madh të kërkesave e ka pasur Dogana e Kosovës.

Më poshtë është paraqitur tabela me të dhënat dhe numrin e kërkesave të parashtruara për qasje në dokumente publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ministrinë dhe agjencitë vartëse. Në të gjitha tabelat numri i kërkesave të refuzuara dhe pa përgjigje, janë të përfshira në të njëjtën rubrikë, bazuar në nenin 10 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Tabela nr. 10:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ministrinë dhe në agjencitë vartëse

	Emri i institucionit	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar/ Pa përgjigje	Qasja e pjeshme	Totali
1	Zyra e Kryeministrit	27	5	0	32
2	<i>Agjencia e Statistikave të Kosovës</i>	16	0	0	16
3	<i>Agjencia për Barazi Gjinore</i>	2	0	0	2
4	<i>Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike</i>	0	0	0	0
5	<i>Këshilli Ndërministror për Ujëra</i>	0	0	0	0
6	<i>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë</i>	0	0	0	0
7	<i>Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore</i>	0	0	0	0

8	Ministria e Integrimit Evropian	27	6	1	34
9	Ministria për Komunitete dhe Kthim	9	0	0	9
10	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	19	0	0	19
11	<i>Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës</i>	0	0	0	0
12	<i>Agjencia Kadastrale e Kosovës</i>	0	0	0	0
13	Ministria e Punëve të Brendshme	25	1	0	26
14	<i>Policia e Kosovës</i>	0	0	0	0
15	<i>Akademia e Kosovës për Siguri Publike</i>	0	0	0	0
16	<i>Agjencioni për Menaxhim Emergjent</i>	0	0	0	0
17	<i>Agjencioni për Regjistrim Civil</i>	0	0	0	0
18	<i>Inspektorati Policor i Kosovës</i>	0	0	0	0
19	<i>Agjencioni i Kosovës për Forenzikë</i>	0	0	0	0
20	Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike	12	0	0	12
21	Ministria e Administratës Publike	9	1	0	10
22	<i>Instituti i Kosovës për Administratë Publike</i>	0	0	0	0
23	<i>Agjencia e Shoqërisë së Informacionit</i>	0	0	0	0
24	Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit	10	22	0	32
25	<i>Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror</i>	0	0	0	0
26	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	10	4	0	14
27	<i>Instituti Pedagogjik</i>	0	0	0	0
28	<i>Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve</i>	0	0	0	0
29	<i>Qendra e Studentëve</i>	2	0	0	2

30	<i>Biblioteka Universitare</i>	0	0	0	0
31	<i>Agjencia e Kosovës për Akreditim</i>	0	0	0	0
32	<i>Agjencia për Aftësim Profesional dhe për të Rritur e Kosovës</i>	0	0	0	0
33	<i>Instituti Albanologjik i Prishtinës</i>	0	0	0	0
34	<i>Inspektorati i Arsimit në Republikën e Kosovës</i>	0	0	0	0
35	<i>Instituti i Historisë</i>	0	0	0	0
36	<i>Instituti i Lepasoviqit</i>	0	0	0	0
37	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	17	0	0	17
38	<i>Agjencioni Pjor i Kosovës</i>	0	0	0	0
39	<i>Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë</i>	0	0	0	0
40	Ministria e Drejtësisë	15	8	1	24
41	<i>Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar</i>	0	0	0	0
42	<i>Shërbimi Korrektues i Kosovës</i>	0	0	0	0
43	Ministria e Financave	50	2	0	52
44	<i>Administrata Tatimore e Kosovës</i>	21	1	0	22
45	<i>Dogana e Kosovës</i>	365	0	0	365
46	<i>Agjencioni Qendror i Prokurimit</i>	0	0	0	0
47	<i>Njësia e Inteligjencës Financiare</i>	0	0	0	0
48	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	16	0	0	16
49	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	24	10	1	35
50	<i>Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës</i>	0	0	0	0
51	<i>Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"</i>	0	0	0	0
52	<i>Teatri Kombëtar i Kosovës</i>	0	0	0	0
53	<i>Qendra Kinematografike e Kosovës</i>	0	0	0	0

54	<i>Galeria Kombëtare e Kosovës</i>	0	0	0	0
55	<i>Ansambli Kombëtar Shtetëror i Këngëve dhe Valleve "SHOTA"</i>	0	0	0	0
56	<i>Filarmonia e Kosovës</i>	0	0	0	0
57	<i>Kosovafilmi</i>	0	0	0	0
58	<i>Baleti i Kosovës</i>	0	0	0	0
59	<i>Muzeu i Kosovës</i>	0	0	0	0
60	<i>Instituti Arkeologjik i Kosovës</i>	0	0	0	0
61	<i>Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve</i>	0	0	0	0
62	<i>Qendrat Rajonale të Trashëgimisë Kulturore</i>	0	0	0	0
63	Ministria e Punëve të Jashtme	2	6	0	8
64	<i>Akademia diplomatike e Kosovës</i>	0	0	0	0
65	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	15	6	1	22
66	<i>Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës</i>	0	0	0	0
67	Ministria e Shëndetësisë	30	2	4	36
68	<i>Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës</i>	9	0	0	9
69	<i>Agjencioni i Kosovës për Produkte Medicinale</i>	0	0	0	0
70	<i>Instituti i Kosovës për Shëndetësi Publike</i>	1	0	0	1
71	<i>Qendra Kombëtare për Transfuzion të Gjakut e Kosovës</i>	0	0	0	0
72	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	6	7	2	15
73	<i>Agjencia Kosovare e Standardizimit</i>	0	0	0	0
74	<i>Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare</i>	0	0	0	0
75	<i>Agjencia e Promovimit të Investimeve e Kosovës</i>	0	0	0	0

76	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës	0	0	0	0
77	Agjencia e Metrologjisë së Kosovës	0	0	0	0
78	Agjencia për Pronësi Industriale	0	0	0	0
79	Inspektorati i Tregut				
80	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	24	1	3	28
81	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	23	0	1	24
82	Ministria e Zhvillimit Rajonal	8	0	0	8
83	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë	3	0	0	3
		797	82	14	893

3.4.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ministrinë dhe agjencitë e tyre vartëse

Në tabelën më poshtë janë të prezantuara numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ministrinë dhe agjencitë e tyre vartëse, ku janë të përfshira edhe mënyra e trajtimit të kërkesave dhe ndarja në dy grupe e institucioneve.

Tabela nr 11.

Institucioni/ njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar / Pa përgjigje	Qasja e pjesshme	Totali
ZKM dhe Ministrinë	381	81	14	476
Agjencitë e ZKM-së dhe të Ministrive	416	1	0	417
	797	82	14	893

- Zyra e Kryeministrit dhe Ministrinë
- Agjencitë vartëse të Zyrës së Kryeministrit dhe të Ministrive

- Realizimi i qasjes në dokumente publike

Qeveria e Kosovës është përgjigjur në shumicën e kërkesave të pranuar, duke refuzuar/pa përgjigje dhe duke ju dhënë qasje të pjesshme një numri të kërkesave.

Siç shihet në tabelën më poshtë, qasje e plotë iu është lejuar 93 kërkesave apo 89 për qind, janë refuzuar apo pa përgjigje 82 kërkesa apo 9 për qind, ndërsa iu është dhënë qasje e pjesshme 14 kërkesave apo 2 për qind.




Figura 7.

Realizimi i së drejtës për qasje në dokumente publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës

- Refuzimet

Numri i përgjithshëm i kërkesave të refuzuara apo pa përgjigje në Qeverinë e Kosovës, natyra e kërkesave të parashtuara ka qenë e lidhur me dokumentet e klasifikuara, privatësinë, të dhënat personale dhe konfidenciale, interesat komerciale, sigurinë publike, sigurinë kombëtare dhe mbrojtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare, të gjitha këto të mbështetura në nenin 12 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Numri i refuzimeve të kërkesave dhe natyra e kërkesave për qasje në dokumente publike, në Qeverinë e Kosovës. Përbëjnë kërkesat për dokumentet e klasifikuara dhe privatësia me 28 për qind, të dhënat personale dhe konfidenciale 22 për qind, interesat komerciale me 11 për qind, siguria publike 6 për qind dhe siguria kombëtare dhe mbrojtja e marrëdhënieve ndërkombëtare 5 për qind.




Figura 8.

Numri i kërkesave të refuzuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës

- Forma e kërkesave të pranuar dhe mënyra e dërgimit të përgjigjeve

Pranimi i kërkesave për qasje në dokumente publike në mënyrë elektronike janë bërë 96 për qind, dhe nga 2 për qind kopje fizike dhe në mënyrë elektronike dhe kopje fizike.




Figura 9.
Mënyra e pranimit të kërkesave për qasje në dokumente publike

Qeveria e Republikës së Kosovës nga të gjitha kërkesat e pranuar, në mënyrë elektronike iu është përgjigjur 93 për qind të kërkesave, ndërsa në mënyrë elektronike dhe kopje fizike 4 për qind, kopje fizike dhe CD 3 për qind.




Figura 10.
Mënyra e dërgimit të përgjigjeve në qasje në dokumente publike

- Profili i aplikuesve

Për dallim prej viteve të kaluara kur me numër të kërkesave kanë dominuar organizatat buxhetore, gjatë vitit 2018 numri më i madh i kërkesave për qasje në dokumente publike janë parashtruar nga gazetarët me 57 për qind të kërkesave, shoqëria civile 24 për qind të kërkesave, që përbëjnë 81 për qind të të gjitha kërkesave, ndërsa 19 për qind janë operatorë ekonomik, studentë, individë dhe organizata buxhetore.




Figura 11.
Profili i aplikuesve për qasje në dokumente publike

- Dokumentet e kërkuara

Kontratat janë dokumentet më të kërkuara në Qeverinë e Republikës së Kosovës, me gjithsejtë 46 për qind, pastaj statistikat me 19 për qind, dhe pjesa tjetër janë raporte me 14 për qind, buxhet, shpenzime dhe vendime me 7 për qind, marrëveshje, projekte dhe konkurse me nga 2 për qind.




Figura 12.
Llojet e dokumenteve të kërkuara në Qeveri gjatë vitit 2018

3.5 UNIVERSITETET PUBLIKE

3.5.1 Numri i kërkesave të parashtruara në Universitetet publike

Në universitet publike gjatë vitit 2018, janë parashtruar gjithsejtë 99 kërkesa për qasje në dokumente publike. Nga të gjitha kërkesat e parashtruara qasje të lejuar kanë marrë 94 kërkesa apo 95 për qind, qasje të pjesshme 5 kërkesa apo 5 për qind e tyre dhe të refuzuara apo pa përgjigje asnjë.

Tabela nr 12:

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike të parashtruara në universitetet publike

	Emri i Institucionit	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar/ Pa përgjigje	Qasja e pjesshme	Totali
1	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"	55	0	0	60
2	Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"	4	0	1	4
3	Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"	7	0	0	7
4	Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka"	4	0	0	4
5	Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka"	24	0	0	24
		94	0	5	99

3.5.2 Analizë e kërkesave të parashtruara në Universitet publike

- Realizimi i qasjes në dokumente publike

Gjatë vitit 2018, nga numri i përgjithshëm i kërkesave nuk ka asnjë kërkesë të refuzuar, të lejuara janë 95 për qind e kërkesave dhe 5 për qind e kërkesave kanë marrë qasje të pjesshme.




Figura 13.
Realizimi i qasjes në dokumente publike në universitetet publike

- Forma e kërkesave të pranuar dhe e përgjigjeve të dërguara

Kërkesat për qasje në dokumente publike gjatë vitit 2018, tek universitet publike 45 për qind e kërkesave janë parashtruar në mënyrë elektronike, 38 për qind në formë elektronike dhe kopje fizike dhe 17 për qind e tyre në kopje fizike.




Figura 14.
Forma e kërkesave të pranuar për qasje në dokumente publike

Përgjigjet që janë kthyer nga universitetet publike gjatë vitit 2018, 52 për qind në mënyrë elektronike, 38 për qind në mënyrë elektronike dhe kopje fizike, 12 për qind në kopje fizike.




Figura 15.
Mënyra e dërgimit të përgjigjeve

- Profili i aplikuesve

Numri më i madh i kërkesave për vitin 2018 tek universitetet publike, kanë qenë nga organizatat buxhetore me 51 për qind të të gjitha kërkesave, 17 për qind e kërkesave kanë ardhur nga individë, me 15 për qind shoqëria civile, 7 për qind gazetarë dhe me nga 5 për qind studentë dhe operator ekonomik.




Figura 16.
Profili i kërkesve të dokumenteve për qasje në dokumente publike, në universitet publike

- Dokumentet e kërkuara

